REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KRYETARI**

Nr.1784/5 Prot. Pogradec, më 21.04.2026

**Lënda :** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**ZNJ. MANJOLA KAMOLLI**
**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuar Znj. Kryetare ,**
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues , :
**"PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË POGRADEC (2026-2030)".**

**Me respekt,**

**KRYETARI**
**Ilir XHAKOLLI**

Nr.i faqeve A4 të projekt-vendimit : 1
Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 3
Nr. i fletëve të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin : 64

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr. ______Prot. Pogradec, më ____. ____. 2026

**PROJEKT- VENDIM**

**Nr._____,Datë_____._____2026**

**PËR**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË POGRADEC 2026-2030"**

Në mbështetje neni 8, 9 dhe 24 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Strategjia Kombëtare për përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëvë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 10/2012 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligji Nr. 96/2017 "Për pakicat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë",

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI:**

**1.** Miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec për periudhën 2026-2030.

**2.** Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe të gjitha Njësitë Administrative.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETAR**
**Manjola KAMOLLI**

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**

Pogradec, më 21.04.2026

# RELACION

**Në lidhje me Projekt-vendimin për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec për periudhën 2026-2030.**

**Akt administrativ kolektiv**

I nderuar Kryetar i Këshillit !
Të nderuar Këshilltarë!

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, me asistencën e Organizatës Drejtësi Sociale ka përgatitur Planin Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec për periudhën 2026-2030, i cili do ti hapë rrugën përmirësimit, shtimit të shërbimeve sociale në bashki për komunitetin rom dhe egjiptian, aplikimit dhe implementimit të projekteve të reja nëpërmjet financimit nga buxheti i bashkisë dhe donatorëve.

**Qëllimi kryesor:**
**Bashkia Pogradec synon të garantojë të drejta të barabarta, të përmirësojë aksesin në shërbime dhe të fuqizojë pjesëmarrjen qytetare të komuniteteve rome dhe egjiptiane në nivel vendor.**

**Parimet e Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec:**

1. Parimi barazisë dhe mos diskriminimit
2. Parimi i gjithpërfshirjes
3. Parimi i integrimit social
4. Parimi i qytetarisë dhe pjesëmarrjes
5. Parimi i decentralizimit

**Metodologjia**

Hartimi i planit u mbështet në një analizë të detajuar të të dhënave sasiore dhe cilësore dhe ka përfshirë disa teknika:

- Analizë social-ekonomike e Bashkisë Pogradec
- Vlerësimi i kapaciteteve institucionale, materiale, financiare dhe njerëzore të bashkisë

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

- Takime me grupe me komunitetet rome dhe egjiptiane
- Të dhëna statistikore dhe publikime
- Hartimi i planit të veprimit
- Buxhetimi i planit

## Fushat e përcaktuara

1. **Arsimi dhe diversiteti kulturor**
   **Objektivi strategjik**: Përmirësimi i nivelit arsimor dhe ofrimi i aksesit më të gjërë në arsimim cilësor dhe gjithpërfshirës për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane, duke përfshirë ata që janë kthyer nga emigracioni.
   **Kjo do tyë arrihet nëpërmjet**:
   - Rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e arsimit në mesin e pakicave rome dhe egjiptiane
   - Përmirësimit të aksesit në shërbime arsimore dhe gjithpërfshirëse për fëmijët e pakicave rome dhe egjiptiane
   - Ofrimi i mbështetjes me shërbime për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëvë me aftësi ndryshe
   - Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit kulturor
2. **Mbrojtja shoqërore dhe përfshirja sociale**
   **Objektivi strategjik:** Rritja e mirëqënies sociale të pakicave rome dhe egjiptiane
   **Kjo do të arrihet nëpërmjet:**
   - Përmirësimi i aksesit të pakicave rome dhe egjiptiane në programet dhe shërbimet e mbrojtjes sociale
   - Forcimi i mekanizmit mbrojtës të rasteve në rrezik shfrytëzimi dhe trafikimi
3. **Punësimi dhe fuqizimi ekonomik**
   **Objektivi strategjik:** Fuqizimi ekonomik i individëve dhe familjeve të pakicave rome dhe egjiptiane përmes punësimit të rregullt dhe të qëndrueshem
   **Kjo do të arrihet nëpërmjet:**
   - Rritja e ndërgjegjësimit dhe nivelit të informacionit për rëndësinë dhe metodat e kërkimit të punës së rregullt tek pakicat rome dhe egjiptiane
   - Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve nga pakicat rome dhe egjiptiane
   - Nxitja e punësimit të rregullt për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane duke rritur aksesin në programet e nxitjes së punësimit
   - Nxitja e punësimit të rregullt për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane përmes krijimit të mundësive për punësueshmëri
   - Rritja e punësimit për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane përmes nxitjes së sipërmarrjes sociale dhe vetëpunësimit të formalizuar
4. **Strehimi dhe kushtet e banimit**
   **Objektivi strategjik:** Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane të kenë akses të plotë në shërbimet e strehimit dhe të jetojnë në kushte strehimi dhe infrastrukturë të përmirësuar
   **Kjo do të arrihet nëpërmjet:**
   - Garantimi i aksesit dhe përfitimit të shërbimeve të strehimit në nivel vendor për pakicat rome dhe egjiptiane
   - Përmirësimi i infrastrukturës në zonat e banuara nga pakicat rome dhe egjiptiane
5. **Shëndeti dhe kujdesi shëndetësor**
   **Objektivi strategjik:** Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane

**Kjo do të arrihet nëpërmjet:**

- Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e kujdesit ndaj shëndetit dhe për një mënyrë jetese të shëndetshme.

Për çdo fushë janë përcaktuar aktivitetet, gjithashtu është llogaritur një kosto e përafërt dhe janë përcaktuar burimet e financimit.

Strategjia Kombëtare për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 10/2012 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligji Nr. 96/2017 "Për pakicat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre, Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës, Planit Kombëtar për Strehimin 2021-2030, do të rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve për të gjitha fushat e përcaktuara dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor.

Prandaj, kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij plani si një mundësi e mirë për të realizuar objektivat e sipërshënuara dhe prioritetet e Bashkisë në lidhje me Komunitetin Rom dhe Egjiptian.

**Ju Faleminderit!**

Konceptoi: Ivana Capollari
Jurist: Eljana Blacëri
Miratoi: Entela Gusho
Konfirmoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR**
**Ilir XHAKOLLI**

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

# *PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË POGRADEC (2026-2030)*

*Ky plan është hartuar nga organizata Drejtësi Sociale me mbështetjen e Bashkisë Pogradec dhe në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale Pogradec, në kuadër të projektit ``Promovimi dhe realizimi i të drejtave të romëve në Kosovë dhe Shqipëri`` implementuar me mbështetjen e Karl Kübel Stiftung für Kind und Familie (KKS) dhe Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e organizatës Drejtësi Sociale dhe nuk mund të reflektojë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Karl Kübel Stiftung apo Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim.*

*Hartuar nga: Drejtësi Sociale*

*Tabela e Përmbajtjes*


- HYRJE
- RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË PLANIT
- PARIMET KU MBËSHTETET PLANI
- KUADRI LIGJOR DHE POLITIK
- METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË POGRADEC (2026-2030)
- PROFILI I BASHKISË POGRADEC
- KOMUNITETI ROM DHE EGJIPTIAN NË BASHKINË POGRADEC
- FUSHAT KRYESORE TË PLANIT
- Arsimimi
- Mbrojtja Sociale
- Punësimi dhe aftësimi profesional
- Strehimi dhe infrastruktura
- Shëndetësia
- PRAKTIKA POZITIVE
- VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT
- MATRICA E PLANIT TË MASAVE: PLANI VENDOR PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJE TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE 2026-2030, BASHKIA POGRADEC
- REFERENCA

***Falenderime***

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec për periudhën 2026–2030 paraqet një hap të rëndësishëm drejt garantimit të të drejtave të barabarta, përmirësimit të aksesit në shërbime dhe fuqizimit të pjesëmarrjes qytetare të komuniteteve rome dhe egjiptiane në nivel vendor. Ky plan bazohet në parimet e gjithëpërfshirjes, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe pjesëmarrjes aktive të vetë komuniteteve si aktorë të ndryshimit.

Për realizimin e këtij plani të domosdoshëm dhe kompleks falënderojmë në mënyrë të veçantë Bashkinë Pogradec për angazhimin në ekspertizë, në sigurimin e informacioneve të nevojshme dhe vullnetin politik në hartimin e këtij dokumenti strategjik. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Qendrës Drejtësi Sociale dhe Bashkisë Pogradec është vetëm një fazë e procesit, por njëherazi dëshmi e gatishmërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave lokale që synojnë krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët pavarësisht përkatësisë së tyre etnike apo statusit socio-ekonomik.

Ky plan është hartuar falë kujdesit, angazhimit të posacëm dhe bashkëpunimit me **Drejtoria e Shërbimeve Sociale Bashkia Pogradec, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Pogradec, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria Rajonale e Punësimit, Pogradec**.

Gjithashtu shprehim mirënjohje të thellë ndaj **përfaqësuesve të pakicave rome dhe egjiptiane**, që kanë mundësuar reflektimin e nevojave reale të komuniteteve respektive dhe kanë bërë të mundur hartimin e një plani solid që mund të ndihmojë në përmirësimin sistematik të kushteve të tyre të jetesës në Bashkinë Pogradec.

## HYRJE

Plani bazohet në parimet dhe objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025). Mbështetur në këtë dokument plani reflekton frymën e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe përfshirjen sociale. Kësisoj qasja e aplikuar mundëson hartimin e një dokumenti strategjik që synon të motivojë dhe orientojë ndërhyrjen sistemike dhe të qëndrueshme në funksion të përmirësimit të jetesës së këtyre pakicave.

Plani Lokal i Veprimit do të fokusohet në këto fusha kryesore:

1. **Arsimi dhe trashëgimia kulturore** – Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së arsimit për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe promovimi i trashëgimisë kulturore.
2. **Punësimi dhe mbrojtja sociale** – Rritja e mundësive të punësimit dhe forcimi i shërbimeve sociale.
3. **Strehimi dhe infrastruktura** – Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe përmirësimi i kushteve infrastrukturore.
4. **Shëndetësia** – Garantimi i qasjes së barabartë në shërbimet shëndetësore.
5. **Përfshirja sociale dhe mundësitë e barabarta** – Promovimi i pjesëmarrjes aktive në jetën publike dhe sociale.

**Plani Lokal i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec (2026-2030)** është një dokument strategjik i domosdoshëm sepse mbart përmasën e një politike lokale themelore që mund dhe duhet të bëhet referencë kyçe për të gjithë institucionet në nivel qendror dhe vendor, organizatat jo fitim-prurëse dhe cdo aktor që synon përmirësimin e kushteve të jetesës si dhe integrimin e pakicës rome dhe pakicës egjiptiane brenda territorit të Bashkisë Pogradec. Ky Plan hartohet pas një periudhe të gjatë mungese të planeve të dedikuara, duke qenë se dokumenti i fundit i kësaj natyre ka qenë Plani Vendor 2013-2015. Hartimi i planeve strategjikë të këtij lloji janë njëherazi manifestim i vullnetit të pushtetit lokal për krijuar kushte të barabarta për të gjithë qytetarët.

Nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të këtij plani në të ardhmen, Bashkia Pogradec shpreh plotësisht angazhimin e saj për një shoqëri më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse, duke kontribuar kështu në stabilitetin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Gjithashtu, ky Plan inkuadrohet si një zhvillim i rëndësishëm në kuadër të deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të Bashkimit Evropian, ku Shqipëria ka shprehur angazhimin e saj për të vazhduar dhe intensifikuar përpjekjet për të arritur barazi të plotë dhe integrimin e romëve. Kjo do të realizohet veçanërisht përmes zbatimit dhe monitorimit të konkluzioneve të përbashkëta të aktiviteteve, duke u fokusuar në sektorët kyç si Punësimi, Strehimi, Arsimi, Shëndetësia, Regjistrimi Civil, Mbrojtja Sociale dhe Mos-Diskriminimi.

Shqipëria është angazhuar gjithashtu për zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e standardeve rajonale mbi buxhetimin publik në lidhje me integrimin e romëve dhe egjiptianëve. Kjo përfshin rritjen e buxhetit publik, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, për politikat që synojnë integrimin e këtyre komuniteteve. Një aspekt i rëndësishëm i këtij angazhimi është krijimi i kanaleve dhe mekanizmave zyrtare që lejojnë përfshirjen aktive të qeverisjes vendore dhe komunitetit rom në proceset e formulimit të politikave, vendimmarrjes, zbatimit dhe monitorimit të iniciativave për arritjen e objektivave të kësaj deklarate.

Për këtë arsye, ky Plan është thelbësor për të siguruar që komunitetet rome dhe egjiptiane të kenë një rol aktiv në proceset që ndikojnë në jetën e tyre, duke garantuar kështu një qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive ndaj integrimit dhe barazisë.

## PARIMET KU MBËSHTETET PLANI

Plani Lokal i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Pogradec (2026-2030) është i bazuar në disa parime të rëndësishme, që synojnë të promovojnë barazinë, përfshirjen sociale dhe respektimin e të drejtave të njeriut për komunitetet rome dhe egjiptiane.

**Parimi i barazisë dhe i mos-diskriminimit të padrejtë**

Ky është një parim i cili ka baza të qarta kushtetuese (neni 18), sipas të cilave organi legjislativ detyrohet që në veprimtarinë e vet ligjvënëse të orientohet nga realizimi i mundësive të barabarta, për përmbushjen e të drejtave për të gjitha subjektet. Sipas parimit të barazisë, të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta në dinjitet dhe të drejta. Askush nuk duhet privilegjuar apo diskriminuar për shkak të gjinisë, racës, fesë etnisë, gjuhës, bindjeve politike fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale, etj. Barazia dhe mosdiskriminimi janë në themel të të gjithë standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas lidhur me pakicat dhe grupe të tjera në pozita jo të favorshme.

Parimi i integrimit social

Një tjetër parim i rëndësishëm i Planit është ai i përfshirjes sociale të popullatës rome dhe egjiptiane. Pavarësisht përpjekjeve të bëra në vitet e fundit, kjo kategori e popullsisë përfaqëson akoma një nga kategoritë më të pafavorizuara, duke u prekur kështu drejtëpërdrejtë nga procesi i përjashtimit social. Në këto kushte, është e rëndësishme të rriten përpjekjet për të promovuar aksesin në punësim dhe në të gjitha burimet, të drejtat, të mirat dhe shërbimet në favor të popullatës rome dhe egjiptiane që përjetojnë përjashtimin social apo janë të ekspozuar ndaj këtij fenomeni. Mbi bazën e këtij parimi, plani synon të ulë dhe parandalojë rrezikun e përjashtimit social, duke vepruar në favor të individëve dhe familjeve më të rrezikuara rome dhe egjiptiane, si dhe duke aktivizuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar.

Parimi i qytetarisë dhe i pjesëmarrjes

Dinjiteti dhe drejtësia janë dy nga themelet mbi të cilat duhet të veprojnë institucionet dhe shoqëria civile me qëllim për të promovuar ushtrimin e plotë të të drejtave nga të gjithë individët. Mbrojtja e të drejtave qytetare të popullsisë rome dhe egjiptiane në Shqipëri, përfshin domosdoshmërisht përmirësimin e imazhit të tyre publik dhe njohjen e kontributit pozitiv të kulturës së tyre ndaj shoqërisë shqiptare. Ndërsa ka patur përpjekje të shumta dhe të ndryshme nga institucionet dhe organizatat jo fitimprurëse për të përmirësuar imazhin publik të popullsisë rome dhe egjiptiane, ka akoma përceptime negative nga grupe të ndryshme të shoqërisë të cilat çojnë në situata diskriminuese për këto grupe. Me qëllim që të garantohet ushtrimi i të drejtave të qytetarisë dhe për t'i bërë anëtarët e komuniteteve rom dhe egjiptian të ndjehen të realizuar në jetën e tyre të përditshme, është absolutisht thelbësore që organet publike dhe private t'u lehtësojnë aksesin dhe t'i inkurajojnë të marrin pjesë në të gjitha fushat e jetës publike, politike dhe sociale. Pjesëmarrja

duhet të ushtrohet në të gjitha nivelet që nënkupton qoftë përfaqësimin në nivele qeverisëse, qoftë atë në nivele të pjesëmarrjes aktive në jetën e përditshme. Është gjithashtu e nevojshme të inkurajohet pjesëmarrja e anëtarëve të grupeve më të përjashtuara, të cilët kanë akoma shumë për të bërë për të arritur ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre si qytetarë të shtetit shqiptar.

Parimi i decentralizimit

Një nga parimet bazë për qeverisjen vendore, në Shqipëri dhe në vende të tjera me traditë demokratike të shtetit është parimi i decentralizimit të pushtetit. Ky parim qëndron në themel të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që i jepet decentralizimit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes. Në këtë kuadër, ky dokument bazuar në parimin e decentralizimit politik synon t'u japë anëtarëve të komuniteteve rom dhe egjiptian, si dhe përfaqësuesve të zgjedhur, më shumë pushtet në procesin e vendimmarrjes. Hartimi i këtij plani veprimi është mbështetur në parimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

Parimi i "masave të veçanta" që nuk diskriminojnë mazhorancën

'Masat e veçanta" për pakicat apo grupe të tjera etnike – gjuhësore nuk duhet të diskriminojnë pjesën tjetër të popullsisë. Arritja e barazisë substanciale mund të kërkojë marrjen e masave të veçanta dhe të tilla masa nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese. Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (neni 4), ndalon në mënyrë të veçantë diskriminimin e bazuar mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare dhe sanksionon se marrja e masave plotësuese dhe të përshtatshme mund të kërkohet për të promovuar barazinë e plotë dhe efektive midis personave që i përkasin pakicave dhe atyre që i përkasin shumicës së popullsisë. Të tilla masa nevojiten të jenë në përputhje të plotë me parimin e propocionalitetit me qëllim që të mos konsiderohen diskriminuese ndaj pjesës tjetër të shoqërisë, përderisa ato përmbushin kushte të caktuara (diskriminimi pozitiv) dhe shërbejnë për të balancuar sjelljet diskriminuese.

Bazuar në këto parime, i gjithë Plani është konceptuar duke përfshirë komponentët si më poshtë:

- Hartimi i politikave efektive dhe jo-diskriminuese – Objektivat e përfshira në Plan kanë si qëllim integrimin e romëve dhe egjiptianëve, si vlera themelore të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, përfshirë të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe zhvillimin ekonomik.
- Qasje e synuar për çështje specifike – Plani i Veprimit propozon strategji të veçanta për të adresuar situatat emergjente që nuk mund të zgjidhen me burime të zakonshme.
- Promovimi dhe nxitja e integrimit social– Aktivitetet e Planit synojnë të inkurajojnë përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane në shoqëri.
- Respekti për dallimet dhe promovimi i diversitetit– Plani njeh dhe respekton dallimet që ka komuniteti Rom dhe Egjiptian, edhe mes vete këtyre dy grupeve.
- Angazhimi i romëve dhe egjiptianëve – Plani ka përfshirë mekanizma që lejojnë angazhimin e pakicave rome dhe egjiptiane në proceset e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave publike.
- Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve– Zbatimi i Planit mbështetet në parimin e bashkëpunimit mes qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, organizatave ndërkombëtare dhe veçanërisht vetë komuniteteve.
- Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale – Plani trajton nevojat në fusha kyçe si arsimi, dialogu ndërkulturor, shëndetësia, strehimi, punësimi, mbrojtja sociale, regjistrimi civil dhe aksesin në drejtësi, me qëllim nxitjen e integrimit gjithëpërfshirës.
- Politika të bazuar në evidenca – Plani ka përcaktuar tregues të qartë për matjen e progresit, si dhe udhëzon mbledhjen e të dhënave periodike për të monitoruar aktivitetet e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve.
- Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor – Plani nënvizon se gratë rome dhe egjiptiane janë më të prirura ndaj përjashtimit dhe diskriminimit gjinor, por gjithashtu thekson se ato luajnë një rol kyç në promovimin e integrimit.
- Angazhimi i shoqërisë civile– Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, partnerët e tjerë dhe vetë komunitetet rome është thelbësor për realizimin e suksesshëm të Planit. Këta aktorë kanë kontribuar aktivisht në hartimin e tij dhe do të angazhohen në zbatim, monitorim dhe vlerësim.

- Buxhetimi për zbatimin – Bashkia Pogradec ka identifikuar burimet financiare për zbatimin e aktiviteteve. Në rastet kur është e nevojshme financimi shtesë, bashkia ka përcaktuar nevojat financiare ku mund të kërkohet ndihmë nga donatorët.

## KUADRI LIGJOR DHE POLITIK

Hartimi i Planit përputhet me kuadrin ligjor dhe politik kombëtar dhe ndërkombëtar që garanton dhe detyron respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe siguron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësive të tyre.

Shqipëria ka ndërmarrë një sërë masash legjislative, strategjike dhe politike për përmirësimin e kushteve të komuniteteve rom dhe egjiptian, duke mbuluar fusha si arsimi, punësimi, strehimi, shëndetësia dhe përfshirja sociale. Në Shqipëri, respektimi i të drejtave të pakicave është i garantuar nga dokumenti themeltar, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, dhe forcohet përmes konventave ndërkombëtare që janë ratifikuar nga vendi ynë, si dhe nga ligjet dhe aktet nënligjore. **Strategjia Kombëtare për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021-2025** është dokumenti kyç që përcakton prioritetet për arritjen e barazisë dhe përfshirjes sociale, duke u fokusuar në eliminimin e diskriminimit dhe fuqizimin e këtyre komuniteteve në jetën publike dhe ekonomike. Ky dokument politik përcakton se deri në fund të vitit 2025: i) rreth 60% e punëkërkuesve romë dhe egjiptianë do të jenë të punësuar ose do të marrin pjesë në Programet e Nxitjes së Punësimit; ii) do të ketë së paku 300 romë dhe egjiptianë që do të kenë marrë mbështetje financiare dhe do të jenë integruar në ekonominë formale; iii) rreth 70% e romëve dhe egjiptianëve që marrin asistencën sociale do të dalin nga skema e mbështetjes dhe do të riintegrohen në tregun e punës. Plani Kombëtar gjithashtu i kushton vëmendje specifike çështjeve të racizmit ndaj romëve dhe egjiptianëve duke parashikuar aktivitete dhe objektiva konkrete në fushën e antixhipsizmit. Strategjia pason nismat si **Dekada e Përfshirjes së Romëve (2005-2015)** dhe **Plani Kombëtar i Veprimit për Romët 2016-2020**, të cilët krijuan një bazë për zbatimin e politikave ndërsektoriale.

Për arritjen e rezultateve që qëndrojnë në linjë me Planin Kombëtar, është thelbësore një bashkëpunim efektiv midis nivelit qendror dhe atij vendor. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të

intensifikojnë përpjekjet për mbështetje ndaj pakicave rome dhe egjiptiane në territorin e tyre, si edhe duhet të forcojnë kapacitetet për mbledhjen e informacionit në nivel lokal për t'u përdorur në politikëbërje dhe vendimmarrje. Për këtë aryse, hartimi i Planit Lokal të Bashkisë Pogradec është një instrument i domosdoshëm në funksion të përmbushjes së rezultateve të Planit Kombëtar, dokumentimit të praktikave pozitive, si dhe identifikimin e ndërhyrjeve të vazhdueshme.

Në nivel legjislativ, **Ligji Nr. 10/2012 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"** garanton të drejta të barabarta dhe mbrojtje nga çdo formë diskriminimi në të gjitha fushat e jetës. Gjithashtu, **Ligji Nr. 96/2017 "Për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë"** njohu komunitetet rom dhe egjiptian si pakica kombëtare, duke u garantuar atyre të drejtën për të ruajtur kulturën, gjuhën dhe traditat. Shqipëria është angazhuar gjithashtu përmes **Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës**, e ratifikuar në vitin 2000, dhe është pjesë e **Deklaratës së Poznanit (2019)** në kuadër të Procesit të Berlinit, ku janë përcaktuar objektiva të qarta për integrimin e romëve në Ballkanin Perëndimor.

Në fushën e arsimit, janë zbatuar masa si **Plani i Veprimit për Arsimin 2016-2020**, i cili synoi të përmirësonte qasjen në arsim dhe të reduktonte braktisjen shkollore ndër romët dhe egjiptianët. Kjo ka përfshirë mbështetje financiare për tekstet shkollore, transportin falas dhe programe për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve rom dhe egjiptian në arsimin parauniversitar.

Në sektorin e punësimit, Shqipëria ka zbatuar politika të orientuara drejt trajnimit profesional dhe nxitjes së punësimit, si përmes **Programeve të Nxitjes së Punësimit**, **Subvencionimit të Pagave** dhe **Trajnimit në Punë**, në kuadër të **Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Social 2016-2020**. Këto masa janë shoqëruar me fushata ndërgjegjësimi për përmirësimin e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës.

Në fushën e strehimit dhe infrastrukturës, janë hartuar dhe zbatuar projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për këto komunitete. **Plani Kombëtar për Strehimin 2021-2030** përfshin masa specifike për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe për të përmirësuar infrastrukturën e lagjeve të banuara kryesisht nga romët dhe egjiptianët.

Shëndetësia është një tjetër fushë ku janë marrë masa specifike. Programe si **Kartat Shëndetësore Falas** dhe **Ekipet e Shëndetit në Komunitet** kanë synuar të përmirësojnë qasjen në shërbime bazë shëndetësore, veçanërisht për grupet më të margjinalizuara.

Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu konventa ndërkombëtare si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (1980), dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që forcojnë angazhimin për respektimin e të drejtave të njeriut. Angazhimi i vendit tonë për integrimin e romëve dhe egjiptianëve është gjithashtu evident në procesin e saj të integrimit evropian, ku janë krijuar kushte më të mira për mbështetje dhe përfshirje sociale. Këto nisma ligjore dhe politike janë një reflektim i përpjekjeve të vazhdueshme për të adresuar sfidat që këto komunitete hasin në jetën e përditshme dhe janë marrë si baza të rëndëishme përgjatë hartimit të Planit.

## METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË POGRADEC (2026-2030)

Për hartimin e Planit në Bashkinë Pogradec, është aplikuar një metodologji gjithëpërfshirëse duke siguruar përfshirjen aktive të komunitetit rom dhe egjiptian, institucioneve lokale, organizatave jo fitimprurëse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Hartimi i Planit u mbështet në një analizë të detajuar të të dhënave sasiore dhe cilësore, duke përfshirë burime primar dhe sekondare informacioni, të mbledhura në Bashkinë Pogradec. Metodologjia e përdorur për kërkimin ka përfshirë disa teknika si:

- Takime/fokus grupe me komunitetet rome dhe egjiptiane;
- Intervista gjysmë të strukturuara me aktorë kyç në këto komunitete;
- Të dhëna statistikore dhe publikime.
- Workshop fokus grup me përfaqësues të instituioneve locale të Bashkisë Pogradec

Mbledhja e të dhënave është mundësuar përmes punës në terren nga ekspertët dhe përfaqësuesit e organizatës Drejtësi Sociale duke u bazuar në takime direkte me komunitetet rome dhe egjiptiane (në takime individuale ose fokus grupe), si dhe në biseda me aktorë nga strukturat shtetërore dhe jo-shtetërore në nivel lokal.

Plani është konsultuar me një sërë përfaqësues të strukturave të ndryshme, si:

-Bashkia Pogradec

-Drejtoria e Shërbimeve Sociale

-Shërbimi i Kujdesit Shëndetësor dhe Vlerësimit të Cilësisë, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor

-Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Pogradec, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar

-Drejtoria Rajonale e Punësimit, Pogradec

-Përfaqësues të pakicave rome dhe egjiptiane

Çdo fushë që përfhsihet në planin e veprimit është trajtuar me kujdes duke specifikuar aktivitete konkrete, indikatorët, aktorët përgjegjës, mbështetjen e nevojshme si dhe buxhetin e parashikuar, duke identifikuar burimet financiare potenciale nga pushteti qendror, lokal ose donatorët.

**Pakica rome dhe pakica egjiptiane në Bashkinë Pogradec**

Bashkia Pogradec është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë dhe përfshin njësitë administrative, Bashkia Pogradec përbëhet nga 8 njësi administrative: Pogradec, Udënisht, Buçimas, Çërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan, të shtrirë në një sipërfaqe prej 189.65 km2. Sipas Censusit të vitit 2023, Bashkia Pogradec numëron 46 070 banorë.

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për Censusin e Popullsisë dhe Banesave të vitit 2023, në Shqipëri janë regjistruar 12,375 individë të komunitetit egjiptian dhe 9,813 të komunitetit rom.



Pakica rome dhe pakica egjiptiane jetojnë në territorin e Bashkisë Pogradec prej disa dhjetra dekadash. Të vendosur në këtë territor qysh rreth viteve 1940-të, aktualisht ato numerojnë rreth banojnë rreth 598 familje të komunitetit rom/egjiptian me rreth 1 892 banore të komunitetit rom/egjiptian. Në qytet banojnë rreth 394 familje, të shpërndarë në të gjitha lagjet e qytetit duke përfshirë dhe zonën e Kabashit dhe Guri i Kuq, dhe në Njësitë Administrative Buçimas, Çërravë, Velçan dhe Proptisht. Të dy këto grupe etnike përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të diversitetit etnik dhe kulturor të rajonit. Karakteristikë e popullsisë rome dhe egjiptiane në këtë bashki është përqëndrimi i tyre ne zonën e urbanizuar (pra në të gjitha lagjet kryesore të qytetit të Pogradecit) dhe shumë pak prezencë në njësitë e tjera të kësaj bashkie.

Në përgjithësi, në Shqipëri, statistikat e gjeneruara nga burime të ndyshme mbi këto pakica dëshmojnë se varfëria ekzistuese ka ardhur edhe si rezultat i përjashtimit social dhe diskriminimit sistematik. Kjo varfëri është shumëdimensionale dhe e qëndrueshme. Romët dhe egjiptianët në qytetin e Pogradecit kanë të ardhura të pakta dhe vuajnë nga kushte të këqija jetese. Ata nuk kanë ose kanë akses të kufizuar në shërbimet publike, hasin vështirësi në aksesimin e shërbimit mjekësor dhe në raport me arsimimin e fëmijëve, kanë vështirësi ose mungesë aksesi në tregun e punës dhe në disa raste në regjistrimin civil.

**Analiza e situatës në bazë të fushave kryesore të planit**

- **Arsimimi**

Komunitetet rome dhe egjiptiane në Shqipëri përballen me një sërë nevojash që janë rezultat i skajimit, varfërisë, segregimit dhe përjashtimit shoqëror në një kontekst historik. Një nga çështjet më të dukshme është aksesimi i kufizuar në arsim cilësor dhe në mjaft raste braktisja e shkollimit

si pasojë e gjendjes social-ekonomike. Fëmijët dhe të rinjtë romë dhe egjiptianë shpesh rriten në mjedise që nuk nxisin progresin dhe përfshirjen akademike, duke u shoqëruar me norma të larta të braktisjes shkollore dhe, si rrjedhojë, kufizime në mundësitë e tyre të punësimit dhe zhvillimit ekonomik në të ardhmen.

Sipas PISA, rezultatet mesatare të Shqipërisë për vitin 2022 ishin më të ulëta krahasuar me vitin 2018 në matematikë, lexime dhe shkencë. Përkeqësimi i rezultateve në Shqipëri lidhej gjithashtu me dëmtimet e infrastrukturës shkollore nga tërmeti i vitit 2019, i cili ka ndërprerë mësimin për shumë nxënës, pandemia e COVID-19 dhe gjendja e dobët e infrastrukturës digjitale, e cila shkaktoi vështirësi për mësimin online. Për më tepër, nxënësit nga grupet socio-ekonomike të margjinalizuara (si komunitetet Rome dhe Egjiptiane, migrantë) kanë gjashtë herë më shumë mundësi të kenë rezultate të ulëta në matematikë krahasuar me nxënësit e tjerë. Në lidhje me lëndë të tjera të lidhura me gjuhën, leximin dhe shkencën, mundësitë për performancë të ulët janë gjithashtu më shumë se pesë herë më të mëdha për nxënësit nga grupet vulnerabël krahasuar me nxënësit që nuk iu përkasin këtyre grupeve.

Pra, në aspektin e edukimit, fëmijët nga familjet me të ardhura të ulëta ose që bëjnë pjesë në grupe vulnerabël, si Romët dhe Egjiptianët, nuk kanë mundësi të barabarta për të aksesuar institucionet arsimore, si dhe për përparimin e tyre akademik (Rezultatet PISA, 2022). Përmirësimi dhe rritja e aksesit në edukim për Romët dhe Egjiptianët, është e rëndësishme për sigurimin e integrimit të tyre, krijimin e mundësive të reja dhe nxitjen e kohezionit shoqëror ndërmjet grupeve të ndryshme.

Në kuadër të hartimit Planit Vendor, janë marrë të dhëna të detajuara të lidhura me bashkinë Pogradec në lidhje me procesin e arsimimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Këto të dhëna i përkasin vitit akademik 2022-2026 sikurse reflektohen edhe në tabelat më poshtë:

Të regjistruar në arsimin e mesëm

| **Viti** | Klasa | Nr. Rom | Nr. Egjiptian |
|---|---|---|---|
| 2022-2023 | Shkolla e Mesme | 24 meshkuj<br>Femra -9 | 61 meshkuj<br>Femra-23 |
| 2023-2024 | | 8 | 69 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Femra-2 | Femra-23 |
| 2024-2025 | | 11<br>Femra-3 | 78<br>Femra-35 |
| 2025-2026 | | 6<br>Femra-0 | 27<br>Femra-11 |

Në këtë tabelë përfshihen të gjitha shkollat e Mesme gjithashtu edhe Shkolla Profesionale "Enver Qiraxhi". Për vitin 2025-2026 nuk është e përfshirë shkolla Profesionale.

*Të regjistruar në arsimin 9 vjecar*

| Viti | Klasa | nr.rom | nr.egjiptian |
|---|---|---|---|
| 2022-2023 | 1-5 | 19 meshkuj<br>Femra-6 | 27 meshkuj<br>Femra-12 |
| | 6-9 | 12<br>Femra-4 | 29<br>Femra-16 |
| 2023-2024 | 1-5 | 33<br>Femra-15 | 87<br>Femra-35 |
| | 6-9 | 16<br>Femra-7 | 78<br>Femra-26 |
| 2024-2025 | 1-5 | 32<br>Femra-9 | 81<br>Femra-28 |
| | 6-9 | 23<br>Femra-9 | 85<br>Femra-37 |
| 2025-2026 | 1-5 | 30<br>Femra-10 | 78<br>Femra-22 |
| | 6-9 | 15<br>Femra-4 | 58<br>Femra-24 |

Megjithëse nga institucionet përkatëse të pyetur në lidhje me braktisjen raportohet se nuk janë evidentuar raste, duke ju referuar të dhënave rezulton se për vitin 2024-2025 ishin 4 nxënës të komunitetit Rom/Egjiptian me tendencë braktisje te arsimin 9-të vjeçar, por janë rikthyer përsëri në shkollë.

Përqindja e nxënësve romë dhe egjiptianë që kanë përfunduar arsimin e lartë nuk është e disponueshme, duke treguar mungesën e ndjekjes së rezultateve të arsimit të lartë. Po ashtu, nuk raportohet që nxënës nga ky grup që të ketë përfituar kuota të veçanta në universitetet përkatëse.

Masat e marra për nxitjen e fëmijëve nga këto komunitetet që të frektuentojnë arsimin parauniversitar referuar bashkisë rezulton të jenë librat falas, mjetet didaktike në kopshte të mundësuara nga bashkia si dhe mbështetje financiare. Ofrohen bursa për nxënës ekselente por nuk ka përfitues nga komuniteti rom/egjiptian me synim lehtësimin e kushteve që favorizojnë frekuentimin e rregullt të arsimit parauniversitar. Kësisoj përmes analizës së të dhënave evidentohet fakti që nuk kemi të bëjmë me një adresim të posacëm për sigurimin e një mbeshtetje specifike financiare të fëmijëve të këtyre komuniteteve megjithëse rezulton se në rang bashkie 56 familje rome dhe 156 familje egjiptiane trajtohen me ndihmë ekonomike. Por një model i mirë që vlen të replikohet nga ana e bashkisë por edhe e MAS është rasti i shkollës Amarotan.

Aksesi në teknologji dhe internet përbën një tjetër problem shqetësues, pasi nuk raportohet asnjë nxënës që të ketë akses në mjetet teknologjike apo lidhje interneti, të cilat janë thelbësore për të pasur mundësi edukimi të njëjta dhe të barabarta.

Këto të dhëna theksojnë nevojën për ndërhyrje të menjëhershme dhe të koordinuara, përfshirë mbështetjen për uljen e braktisjes shkollore, rritjen e aksesit në teknologji, sigurimin e bursave dhe nxitjen e përfshirjes në arsimin e mesëm dhe të lartë. Përmirësimi i këtyre indikatorëve do të ndikonte ndjeshëm në integrimin arsimor dhe social të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkinë Pogradec.

**Sfidat e lidhura me proçesin e edukimit për nxënësit romë dhe egjiptianë.**

- Alokimi i fondeve të posaçme për arsimin e komunitetit rom dhe egjiptian;

- Sigurimi i buxhetit për burime arsimore, pajisje shkollore shtesë, punësim dhe ndihma për familjet me të ardhura të ulëta.
- Ofrimi i bursave dhe ndihmave financiare për nxënësit që mbarojnë AMU-në me synim ndjekjen e AML-së specifikisht Arsimin e Mesëm Profesional, duke përmiresuar aksesin e fëmijëve në arsim.
- Mobilizimin e donatorëve dhe partnerëve që operojne në vend; përdorimin e fondeve shtesë për projektet pilot dhe realizimin e aktiviteteve mbështetëse.
- Zvogëlimi e barrierave financiare që pengojnë fëmijët romë dhe egjiptiane të përfundojnë arsimin.
- Përmirësim të infrastrukturës dhe cilësisë së arsimit për pakicat rome dhe egjiptiane.
- Përfshirja e nxënësve romë dhe egjiptianë në çdo aktivitet sportiv, kulturor, artistik që shkollat organizojnë.
- Ofrimi i transportit të nxënësve rome dhe egjiptiane që kanë qendrën e banimit mbi 2 km nga shkolla.
- Zhvillimin e takimeve me prindër për të shmangur mungesat dhe rritur cilësinë e mësimnxënies për nxënësit romë dhe egjiptianë.

**Masat e marra nga shkolla për gjithëpërfshirjen e nxënësve romë dhe egjiptianë në aktivitetin e arsimit parauniversitar.**

- Në shkollat e ZVAP Pogradec ofrohet arsim gjithëpërfshirës. Nxënësit romë dhe egjiptianë janë përfshirë në cdo aktivitet të shkollës.
- Janë zhvilluar plane pune për rritjen e cilësisë së mësimnxënies për nxënësit romë dhe egjiptianë.
- Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm mes mësuesve kujdestarë/SHPS me prindërit për të siguruar një frekuentim sa më të lartë në procesin mësimor.
- Hartimi i një plani strategjik të qartë për secilën shkollë në të cilat janë përfshirë objektiva të matshme dhe të arritshme, të orientuara drejt përfshirjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin formal dhe atë gjithëpërfshirës.

- Ngritjen e mekanizmave efektive të monitorimit, specifikisht krijimin e grupeve të punës për të ndjekur zbatimin e politikave arsimore.
- Zbatimin e programeve mbështetëse, specifikisht krijimin e programeve specifike që synojnë ruajtjen e gjendjes aktuale e cila është zero në drejtim të braktisjes shkollore si dhe përmirësimin e pjesëmarrjes në të gjitha veprimtaritë brenda e jashtë institucioneve arsimore.
- Ruajtjen e gjendjes pozitive lidhur me përfshirjen optimale të fëmijëve egjiptianë në procesin arsimor.
- Përmbushjen e objektivave strategjike me efikasitet dhe transparencë.

**Objektivat në fushën e arsimit për të rritur përfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian në 4 vitet e ardhshme, si dhe masat/ aktivitetet e propozuara**

- Gjithëpërfshirja e nxënësve romë dhe egjiptianë në aktivitetin arsimor të institucionit dhe rritja e cilësisë së mësimnxënies.
- Plan pune për rritjen e cilësisë së mësimnxënies të nxënësve romë dhe egjiptianë.
- Kontakt i drejtëpërdrejëe me prindërit e nxënësve romë dhe egjiptianë për frekuentimin në shkollë.
- Plan pune për nxënësit romë dhe egjiptianë me vështirësi në të nxënë.
- Mbështetja e nxënësve romë dhe egjiptianë nga SHPS në shkollë.
- Përfshirja e nxënësve romë dhe egjiptianë në aktivitetet artistike, kulturore dhe sportive të institucionit arsimor.
- Përfshirja e nxënësve romë dhe egjiptianë në klubet e SHQK.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese në nivel institucionesh arsimore por jo vetëm, si dhe përdorimi i aktiviteteve lokale për të promovuar rëndësinë e arsimit.
- Përmirësimi i bashkëpunimit mes famijeve rome dhe egjiptiane me institucionet arsimore;
- Krijimin e praktikave pozitive për aplikimin e dialogjeve të rregullta dhe dhënies së mbështetjes periodike për familjet e komunitetit rom dhe egjiptian si dhe përfshirjen e prindërve dhe komunitetit lokal në vendimarrje dhe implementim.

- Përfshirjen e lidërve të komunitetit; angazhim konkret të figurave të njohura në rreth për të përhapur mesazhe pozitive mbi edukimin dhe rëndësinë e përfshirjes së komunitetit egjiptian në keto takime.
- Përmirësim të perceptimit mbi rëndësine e arsimit brenda komunitetit egjiptian.
- Ritje të angazhimit të familjeve për të mbështetur edukimin e fëmijëve të tyre.

## *Mbrojtja sociale*

Drejtoria e Shërbimeve Sociale (DSHS) në Bashkinë Pogradec është struktura përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh sociale të integruara, me një fokus të veçantë tek komunitetet në nevojë, përfshirë komunitetet rome dhe egjiptiane. Misioni kryesor i këtij drejtorie është krijimi i një sistemi të organizuar dhe të qëndrueshëm shërbimesh shoqërore që garantojnë mirëqenien, mbrojtjen dhe përfshirjen e plotë sociale të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për mbështetje dhe kujdes të veçantë. Përmes shërbimeve që ofron, DSHS synon të adresojë sfidat sociale, ekonomike dhe integruese që hasin grupet vulnerabël, duke siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse në mbështetjen sociale.

*Struktura dhe organizimi i DSHS Pogradec*

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Pogradec është e ndarë në dy sektorë kryesorë, të cilët mbulojnë aspekte të ndryshme të mbështetjes sociale:

1. **Sektori i Ndihmës Ekonomike (NE) dhe Shërbimit Social** – Ky sektor është përgjegjës për administrimin dhe shpërndarjen e skemave të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, duke përfshirë edhe komunitetet rome dhe egjiptiane.

2. **Sektori i Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Mbrojtjes së Fëmijëve** – Ky sektor ofron shërbime sociale për kategori të ndryshme vulnerabël, përfshirë të moshuarit, fëmijët në nevojë, gratë dhe vajzat në situata të vështira, si dhe komunitetet rome dhe egjiptiane.

*Analiza e të Dhënave mbi Mbrojtjen Sociale*

Në vijim, do të prezantojmë të dhënat në lidhje me disa fusha kryesore të mbrojtjes sociale, për të kuptuar më mirë ndikimin dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara nga DSHS Pogradec ku përfshihen **Ndihma Ekonomike; Përkrahje për personat me Aftësi të Kufizuara**; **Shërbimet për komunitetet rome dhe egjiptiane; Mbrojtje e fëmijëve dhe grave në situata të vështira**

- *Mbështetja me Ndihmën Ekonomike*

Të dhënat mbi mbështetjen me ndihmë ekonomike për familjet e komuniteteve rom dhe egjiptiane në Bashkinë Pogradec tregojnë një tendencë të luhatshme gjatë viteve të fundit. Duke krahasuar të dhënat e përfituesve të ndihmës ekonomike pas vitit 2018 numri ka një rënie të konsiderueshme duke ruajtur edhe sot të njëjtin trend. Megjithatë numri i përfituesve nga këto dy pakica vijon të jetë shumë i lartë duke na dëshmuar një tregues domethënës të shkallës së varfërisë së këtyre komuniteteve.

Aktualisht, familje Rome dhe Egjiptiane që trajtohen me pagesën e ndihmës ekonomike nga sistemi i ndihmës ekonomike janë 210 familje. Këto të dhëna, kombinuar me gjetjet e siguruara nga intervistat e zhvilluara në terren me anëtarë të këtyre pakicave tregojnë që numri i familjeve që gjenden e në kushtet e varfërisë ekstreme dhe kanë nevojë për mbështetje përmes ndihmës ekonomike është edhe më i lartë. Këtu përballemi me një anomali të shkaktuar nga reforma në sistemin e ndihmës ekonomike, që konstatohet kudo në Shqipëri dhe të adresuar prej kohësh nga organizata jo fitim-prurëse. Sistemi i mbështetjes me ndihmë ekonomike nuk merr parasysh shkallën dhe shtrirjen reale të varfërisë dhe pamundësisë për të dalë nga qerthulli i saj sidomos për anëtarë të komuniteteve vulnerabël si romët dhe egjiptianët. Kjo gjendje implikon domosdoshmërinë e bashkërendimit të punëve mes institucioneve për të zbutur varfërinë përmes ndërhyrjeve kapilare në sferën e punësimit dhe mmbështetjes me ndihmë ekonomike në përputhje me nevojat reale të familjeve që gjenden në këto kushte si në Pogradec dhe më gjerë.

Në terma të tjerë, mbetet e rëndësishme të analizohet efektiviteti i skemës së ndihmës ekonomike dhe ndikimi i saj në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet rome dhe egjiptiane. Një nga synimet kryesore duhet të jetë që sa më shumë anëtarë të komunitetit të kalojnë nga statusi i përfituesve të ndihmës ekonomike në kontribuues aktivë në shoqëri. Përveç sigurimit të mbështetjes bazë përmes ndihmës ekonomike, është thelbësore që këta individë të kenë mundësi për t'u integruar në tregun e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit, hapjes së bizneseve

startup dhe mbështetjes për zhvillimin profesional. Kjo qasje jo vetëm që do të ndihmojë në rritjen e pavarësisë ekonomike të familjeve rome dhe egjiptiane, por edhe në fuqizimin e tyre social, duke reduktuar varësinë nga ndihma ekonomike dhe duke krijuar një model të qëndrueshëm për përfshirjen dhe zhvillimin e komunitetit.

- ***Mbështetja për P.A.K***

Individët me nevoja të veçanta përballen me një sërë sfidash dhe vështirësi. Nga ana tjetër, këto sfida mbivendosen akoma më shumë kur individët i përkasin grupeve të margjinalizuara. Rritja e numrit të përfituesve të pagesës për aftësinë e kufizuar (P.A.K) në komunitetet rome dhe egjiptiane në Bashkinë Pogradec tregon një tendencë në rritje të mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, por njëkohësisht sinjalizon edhe nevojën për politika më të qëndrueshme që të mundësojnë përfshirjen sociale dhe ekonomike të kësaj kategorie. Aktualisht në bashkinë Pogradec janë 72 individë të komunitetit egjiptian dhe 12 individë të komunitetit Rom përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar.

Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e politikave të qëndrueshme të mbështetjes sociale dhe nevojën për përmirësimin e shërbimeve për këtë kategori, duke garantuar jo vetëm mbështetje financiare, por edhe qasje më të lehtë në shërbimet shëndetësore, arsim dhe punësim të përshtatshëm për individët me aftësi të kufizuara.

Numri i përfituesve të pagesës për aftësinë e kufizuar është rritur ndjeshëm në dekadën e fundit jo vetëm në Pogradec por në të gjithë vendin, duke reflektuar nevojën në rritje për mbështetje sociale. Megjithatë, ky mekanizëm nuk duhet të jetë zgjidhja e vetme, por duhet të shoqërohet me politika që sigurojnë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri dhe tregun e punës. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një mbështetje e qëndrueshme dhe një përmirësim real i cilësisë së jetës për këtë kategori.

- **Të dhëna mbi dhunën në familje**

Të dhënat e raportuara nga strukturat e Koordinatorëve Vendorë Kundër Dhunës në Familje për periudhën 2024-2025 tregojnë një tendencë shqetësuese të dhunës ndaj grave, vajzave dhe fëmijëve nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Më konkretisht, rastet e raportuara të dhunës në

familje janë dhe që trajtohen aktulisht janë 9 raste me urdhër mbrojtje, nga këto 6 gra në zonën urbane dhe 3 në zonën rurale.

Kjo tendencë mund të jetë pasojë e përkeqësimit të kushteve socio-ekonomike, shtimit të mekanizmave të raportimit, rritje të ndërgjegjësimit më të madh të viktimave dhe komunitetit për denoncimin e dhunës, por edhe rritje reale e rasteve të dhunës në familje me bazë gjinore ose kundrejt fëmijëve. Megjithatë është për tu theksuar fakti se nga intervistat e zhvilluara rezulton se kemi të bëjmë me një ulje të rasteve krahasuar me të dhënat e raportuara nga viti 2018 deri në vitin 2023. Nga ana tjetër, pavarësisht përmirësimit të situatës të dhënat sugjerojnë se dhuna në familje mbetet një problem konsistent, i cili kërkon politika të qëndrueshme dhe ndërhyrje të koordinuara midis institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe vetë komunitetit.

Përballë kësaj prirje, është e domosdoshme që institucionet dhe organizatat që punojnë në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje të forcojnë mekanizmat e identifikimit dhe mbështetjes, duke u fokusuar veçanërisht tek grupet më të cenueshme, si gratë dhe fëmijët. Përveç kësaj, duhet të zhvillohen programe të dedikuara për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi pasojat e dhunës, fuqizimin ekonomik dhe social të grave si një strategji parësore për të reduktuar varësinë ekonomike nga agresorët dhe përmirësimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunimi efektiv mund të arrihet një reduktim i ndjeshëm i rasteve të dhunës në familje dhe të sigurohet një mbrojtje më e fortë për viktimat.

- **Të dhëna nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës**

Strukturat e shërbimeve sociale luajnë një rol shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijëve. Në rastin e fëmijëve nga komuniteti rom dhe egjiptian, ata përballen me sfida të shumta, për shkak të vështirësive ekonomike, sociale, përballjes me diskriminimin, përjashtimin social etj.

Të dhënat e raportuara për periudhën 2018-2024 tregojnë një prani të vazhdueshme të rasteve të dhunës dhe cenimit të të drejtave të fëmijëve nga komunitetet rome dhe egjiptiane, duke reflektuar një problematikë që kërkon vëmendje të shtuar institucionale dhe shoqërore. Numri i rasteve të raportuara ka shfaqur luhatje përgjatë viteve, por me një prirje të qëndrueshme që dëshmon se fëmijët e këtyre komuniteteve vazhdojnë të përballen me rrezique të shumta që lidhen me dhunën në familje, neglizhencën dhe mungesën e mbrojtjes së duhur.

Për vitin 2025 Njësia e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve (NJMF-ja) ka menaxhuar 2 raste të komunitetit Egjiptian. Në përgjithësi kërkohen masa të qëndrueshme për mbrojtjen e fëmijëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane, të cilët janë ndër grupet më të rrezikuara nga dhuna, shfrytëzimi, neglizhenca dhe mungesa e mundësive për mbështetje sociale dhe psikologjike.

Nevoja për politika efektive të mbrojtjes së fëmijëve është më urgjente se kurrë. Institucionet përgjegjëse duhet të forcojnë mekanizmat e identifikimit dhe raportimit të rasteve të dhunës, duke përfshirë trajnimin e punonjësve të mbrojtjes sociale, fuqizimin e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe zhvillimin e programeve të posaçme për ndërgjegjësimin e komuniteteve mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Përveç kësaj, është e domosdoshme të krijohen struktura të mbështetjes psikologjike dhe sociale për fëmijët viktima të dhunës, si dhe të rritet mbështetja për familjet në nevojë, duke i ndihmuar ato të kapërcejnë sfidat ekonomike dhe sociale që mund të kontribuojnë në cenimin e sigurisë së fëmijëve. Ndërhyrjet duhet të përqendrohen në parandalimin e dhunës përmes edukimit, krijimit të hapësirave të sigurta për fëmijët, mbështetjes së nënave dhe familjeve të cenueshme, si dhe fuqizimit të komuniteteve për të raportuar dhe adresuar rastet e dhunës në mënyrë efektive. Vetëm përmes një qasje të integruar dhe të qëndrueshme mund të sigurohet mbrojtja e fëmijëve dhe të krijohen kushte më të sigurta për rritjen dhe zhvillimin e tyre të shëndetshëm.

Në këtë linjë, Bashkia Pogradec ka implementuar disa praktika pozitive në nivel vendor për krijimin dhe funksionimin e strukturave mbështetëse për mbrojtjen sociale dhe fuqizimin e komuniteteve vulnerabël. Prej vitesh, kjo bashki ka ngritur Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Grupin Teknik Ndërsektorial për menaxhimin e rasteve, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse në trajtimin e rasteve që kërkojnë ndërhyrje. Po ashtu, është funksionalizuar roli i Koordinatorit kundër Dhunës në Familje dhe Mekanizmit të Referimit, ku çdo rast trajtohet në mënyrë të individualizuar, me plane të qëndrueshme që adresojnë nevojat specifike të individëve apo familjeve të përfshira.

Një tjetër praktikë e konsoliduar në Bashkinë Pogradec është ngritja e 4 qendrave komunitare multifunksionale publike, të cilat ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh sociale dhe zhvillimore. Po ashtu 3 qendra komunitare jo publike të mbështetura nga ojf-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes sociale, promovimin e prindërimit pozitiv, zhvillimin e aktiviteteve pas

shkolle, ofrimin e kurseve profesionale dhe nxitjen e fuqizimit ekonomik për individët dhe familjet që frekuentojnë këto hapësira.

- **Punësimi dhe aftësimi profesional**

Komunitetet rome dhe egjiptiane, përballen me një seri sfidash dhe vështirësish në tregun e punës dhe në fusha të tjera. Zhvillimi i popullatës rome dhe egjiptiane ndikohet nga një sërë faktorësh dhe është e nevojshme të merret parasysh ndërveprimi kompleks i dinamikave sociale, kulturore, politike dhe ekonomike, më qëllim gjithëpërfshirjen dhe integrimin e tyre. Diskriminimi dhe përjashtimi shoqëror pengojnë aksesin e këtyre komuniteteve në arsim, shëndetësi, mundësi të barabarta punësimi dhe progresi. Nga ana tjetër, braktisja e hershme e shkollës, karakteristikë dalluese të popullatës rome dhe egjipti, konsiderohet si një tjetër barrier sinjifikante që pengon zhvillimin ekonomik në fazat e mëvonshme jetësore për shkak të mungesës së aftësive. Mungesa e zhvillimit ekonomik lidhet me mungesën e mundësive për punësim ose aksesin në punësim formal.

Varfëria dhe rëndësia për të përmbushur nevojat bazike jetësore ndikojnë dukshëm në uljen e interesit të individëve romë dhe egjiptianë për tu regjistruar dhe për të përfunduar programet e formimit profesional, duke i detyruar ata të bëjnë zgjedhje alternative që shpesh janë informale, si sektori i grumbullimit të mbetjeve riciklues, tregtimi i mallrave të përdorura ose aktivitete të tjera që nuk kërkojnë trajnim të veçantë. Përveç aspektit ekonomik, puna informale shoqërohet me dëmtime serioze shëndetësore për komunitetin rom. Gjithashtu, shumë fëmijë janë të involvuar në grumbullimin e mbetjeve për të ndihmuar prindërit e tyre. Fëmijët janë automatikisht të ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh dhe janë grupi kryesor që rrezikon të braktisë shkollën ose të martohet herët. (UNICEF, 2019). Po ashtu, kultura e varfërisë dhe përjashtimit, mungesa e besimit në programet ekzistuese të punësimit, përvojat negative nga e kaluara, etj., bëjnë që shumica e romëve dhe egjiptianëve që punojnë në sektorin informal të mbeten në këtë sektor (duke pranuar pasigurinë që sjell tregu i punës informale) dhe të hezitojnë për t'u përfshirë në programet e promovimit të punës.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Pjesëmarrje dhe Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025) ka evidentuar se situata aktuale e punësimit, sidomos pas

ndikimit të pandemisë së COVID-19, është e pasigurtë për shkak të mungesës së të dhënave të përditësuara. Romët dhe egjiptianët gjithashtu përballen me "pengesa të fshehura" në punësim, duke përfshirë distancën nga puna, diskriminimin dhe stigmatizimin për shkak të përkatësisë etnike, migracionin, mungesën e kartave të identitetit dhe dokumenteve të tjera personale dhe administrative, mungesën e arsimitt, mungesën e njohurive për ekzistencën e programeve të punësimit, etj. Ndërkohë që trajnimi profesional dhe programet aktive të punësimit janë të ofruara për individët që janë të regjistruar si punëkërkuese aktiv pranë Zyrave të Punësimit, shumica e romëve dhe egjiptianëve nuk janë të regjistruar dhe, si pasojë, nuk përfitojnë nga këto programe. Po ashtu, sipërmarrësit romë dhe egjiptianë nuk disponojnë informacion të mjaftueshëm lidhur me mundësitë e granteve nga agjencitë qeveritare apo strukturat joshtetëorore.

Një nga elementët kryesorë që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e shkallës së punësimit të romëve dhe egjiptianëve është rekomandimi dhe mbështetja e atyre që përfundojnë një shkollë profesionale ose cikle të tjera të edukimi, për të aplikuar për vende pune të përshtatshme. Romët dhe egjiptianët janë ndër grupet kryesore përfituese të Ligjit Nr. 65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë", megjithatë, që nga hyrja në fuqi e ligjit dhe zbatimi i tij nuk ka pasur përfitues. Qëllimi i këtij ligji është, ndër të tjera, punësimi i grupeve në disavantazh në tregun e punës, duke përfshirë gratë viktima të dhunës dhe trafikimit ose përfaqësues nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Ligji, që kombinon integrimin në punë me ofrimin e shërbimeve sociale, përcakton se ndërmarrjet sociale duhet të ofrojnë një listë të kufizuar shërbimesh sociale për grupet e margjinalizuara dhe njëkohësisht të punësojnë një numër të konsiderueshëm individësh nga këto grupe.

Në bashkinë Pogradec ekziston një shkollë profesionale e quajtur "Enver Qiraxhi" që ofron kurse si: elektriçist, mekanik, hoteleri rurizëm etj. Bazuar në të dhënat e shkollës përfshirja e komuniteteve rome dhe egjiptiane ka pasur luhatje të ndjeshme gjatë viteve të fundit. Aktualisht Në shkollën profesionale janë gjithsej 56 nxënës nga pakicat rome dhe egjiptiane, 8 nxënës Rom dhe 48 nxënës egjiptian. Të gjithë nxënësit të cilët frekuentojnë arsimin professional, janë përfitues të bursës pa asnjë dallim etnie, gjithashtu dhe përfitues të teksteve falas. Ndërsa numri i Romëve dhe Egjiptianëve që janë regjistruar në kurs të arsimit professional janë gjithsej 29, të cilët dhe janë çertifikuar. Po ashtu, gjatë vitit 2025, në kuadër të programeve të Zyrës së Punës Pogradec, rreth 30 gra dhe vajza nga shtresat në nevojë ku përfshihen dhe komuniteti rom/egjiptian, si dhe të

rikthyera nga emigracioni, po ndjekin trajnime për aftësi për jetën dhe punësimin, aftësi digjitale, komunikim dhe këshillim për punësim. Kurset të cilat ofrohen nga zyra e punës janë: kurse parukerie, Guzhine, mekanik elektrik, aftësi dixhitale, aftësi për punësim si dhe të tjera në varësi të kërkesave. Të çertifikuar në kurs të arsimit professional janë 14 Romë dhe 15 Egjiptianë. Kjo situatë tregon nevojën për politika më efektive mbështetëse, përfshirë ndihmë financiare, rritje të aksesit në arsimin profesional dhe zbatim të programeve të mbështetjes sociale për këta nxënës, duke siguruar që të kenë mundësi të barabarta për zhvillim profesional dhe integrim në tregun e punës.

**Të dhëna mbi punësimin dhe aftësimin profesional të komuniteteve Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Pogradec (2024-2025)**

Ndërkaq përsa i përket punësimit apo regjistrimit të komunitetit si punëkërkues të papunë, të dhënat i përkasin vetëm vitit 2024-205. Aktualisht, numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar pranë Zyrës së Punësimit përfshin janë 148 romë dhe 117 egjiptianë.

Integrimi në tregun e punës ka qenë i kufizuar. Nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, Nga programet e nxitjes së punësimit kanë përfituar 3 individë egjiptianë dhe 2 individë të komunitetit rom nga të cilët gëzojnë një punësim të rregullt si rezultat i këtij programi 3 individë të komunitetit egjiptian dhe 2 te komunitetit rom. Sa i përket punësimit të drejtpërdrejtë, janë punësuar gjithsej 14 romë dhe 7 egjiptianë. Në programin e vetëpunësimit nuk ka pasur aplikime nga këto kategori. Lidhur me përfshirjen e të rinjve në praktika pranë institucioneve dhe mundësitë e punësimit pas këtyre praktikave, nuk ekziston asnjë rast përfshirje të të rinjve nga këto pakica. Gjithashtu, skema e Garancisë Rinore për kategorinë NEET nuk është zbatuar në asnjë rast.

Në aspektin e mbështetjes për bizneset, nuk ekziston asnjë rast që të ketë përfituar lehtësira fiskale apo grante të vogla për qëndrueshmëri afatgjatë. Po ashtu, nuk ekziston asnjë rast i bizneseve informale të identifikuara dhe mbështetura për formalizim.

Sa i përket politikave dhe praktikave pozitive, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 15.01.2020, parashikon që komunitetet rom dhe egjiptian të përfitojnë 6 paga minimale dhe 12 muaj sigurime shoqërore, ndryshe nga kategoritë e tjera. Për më tepër, këto kategori janë të përfshira si tregues të veçantë në kartën e performancës së çdo zyre punësimi. Aktivitetet

informuese dhe mbështetëse përfshijnë orientim dhe këshillim individual për çdo punëkërkues nga këto komunitete drejt formimit ose punësimit, megjithëse përfshirja mbetet e ulët.

- **Strehimi dhe infrastruktura**

Komunitetet rome dhe egjiptiane shpesh hasin barriera shoqërore që pengojnë integrimin e tyre në shoqëri. Diferencat kulturore, diskriminimi dhe paragjykimet historike luajnë rol në këtë përjashtim të vazhdueshëm. Për më tepër, shumë anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian jetojnë në kushte tejet të vështira, duke u përballur me probleme lidhur me strehimin, infrastrukturën e papërshtatshme dhe akses të ulët në shërbimet shëndetësor cilësore. Mungesa e infrastrukturës lidhet në mënyrë direkte me privimin nga energjia elektrike, ujin e pijshëm, si dhe të jetuarin me kushte higjeno sanitare të përshtashme. Funksioni i strehimit mbulohet nga një specialist, i sektorit të Kujdesit Social, i cili është njëkohësisht përgjegjës edhe për koordinimin dhe informacionin. Qëllimi i punës së specialistit të strehimit social është të administrojë dhe planifikojë shpërndarjen e programeve sociale për strehim, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshem dhe të përballueshem duke u mbeshtetur në aftesinë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe është përgjegjës për zbatimin e kërkesave sipas ligjit nr.22/2018 "Per Strehimin Social" i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij. Nevoja për strehim social vlerësohet bazuar në numrin e aplikimeve që janë bërë në bashki. Që nga viti 2023, aplikimet për strehim bëhen edhe nëpërmjet sistemit online në e-Albania me asistim të punonjësve të bashkisë.

Bashkia synon të sigurojë kushte të përshtatshme dhe të përballueshme strehimi për banorët e bashkisë Pogradec, me vëmendje të veçantë në grupet më të pafavorizuara si: persona me aftësi të kufizuara; familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna; të moshuarit; familjet me më shumë se katër fëmijë; gra të dhunuara apo viktima të trafikimit; vajzat nëna dhe, anëtarë të komunitetit Rom e Egjiptian.

Qëllimi i PSVS është të sigurojë përmirësimin e kushteve të banimit për rreth 360 familje deri në vitin 2030. Në realizimin e programit 5-vjeçar për strehimin social, Bashkia e Pogradecit aplikon parimet e Strategjisë Kombëtare të Strehimit social:

□ Familjet me të ardhura të ulëta e, veçanërisht, grupet në pozita të pafavorizuara përbëjnë prioritet.

□ Oferta për strehim social vjen e gatshme, e arritshme, e përballueshme dhe me alternativa cilësore.

□ Sektori i strehimit social ndërvepron me sektorë të tjerë brenda shërbimit të mbrojtjes sociale, si dhe me mbrojtjen civile e planifikimin e territorit me qëllim që jo vetëm të rritë ofertën, por edhe të ulë cënueshmërinë e familjeve ndaj riskut të fatkeqësive.

Bazuar në parimet Kushtetuese, Bashkia e Pogradecit e bazon programin 5-vjeçar të strehimit në bashkëfinancimin e programeve në masën 30 – 40% të kostove të projektit dhe në bashkëpunimin me sektorin privat për të rritur fondet përmes instrumenteve të parashikuara në ligjin e strehimit social dhe në legjislacionin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në total në Bashkinë Pogradec numri i të pastrehëve është 360 familje, 150 nga të cilat trajtohen përmes programeve të strehimit social. Meqenëse nuk ekzistojnë statistika të sakta me përafërsi numri i familjeve të pastrehë rom dhe egjiptianë në bashkinë Pogradec është rreth 100 familje egjiptiane dhe rome, 60 nga të cilat janë përfituese të programeve të strehimit social.

Më konkretisht bazuar në të dhënat e zyrës së punës Pogradec situata e strehimit paraqitet në tabelën më poshtë:

| Programi 2022 | Nr.i familjeve | Rom | Egjiptian |
|---|---|---|---|
| Bonus qiraje | 6 | 2 | 4 |
| Privatizim Banese | 4 | 1 | 3 |
| Rikonstruksion Banese | 39 | 9 | 30 |
| Kredi te Buta | 6 | 1 | 5 |

Për periudhen 2022-2024 janë përfitues:

- Bonus qiraje: 15 familje rome/egjiptiane
- Privatizim Banese: 5 familje rome/egjiptiane
- Rikonstruksion banese: 45 familje rome/egjiptiane
- Kredi të buta: 7 familje rome/egjiptiane

Gjatë vitit 2025, Bashkia Pogradec ka vijuar zbatimin e programeve të mbështetjes në fushën e strehimit për familjet në nevojë, përfshirë komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

- Programi i bonusit të qirasë:

Janë paraqitur gjithsej 28 aplikime, nga të cilat 5 aplikues i përkasin komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

Nga këta, 1 familje ka përfituar bonus qiraje.

- Programi i rikonstruksionit të banesave:

Janë regjistruar 22 aplikime në total, prej të cilave 1 aplikues i përket komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

Sikurse mund të konstatohet lehtësisht nga të dhënat pavarësisht punës së bërë nga bashkia Pogradec për strehimin apo përmirësimin e infrastrukturës së strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane, strehimi mbetet një problem që kërkon zgjidhje të plotë. Thënë kjo duke marrë parasysh efektet që prodhon mungesa totale e strehimit ose pasja e një strehimi të përshtatshëm për familjet vulnerabël të kytyre komuniteteve që rrezikon të zgjerojë ciklin e varfërisë dhe margjinalizimit duke e pamundësuar daljen prej kësaj gjendje dhe integrimin e tyre.

- **Shëndetësia**

Në Bashkinë Pogradec, situata e komunitetit rom dhe egjiptian në lidhje me shëndetin është përballur me shumë sfida që lidhen me kushte të pafavorshme socio-ekonomike dhe diskriminim në sektorin e shëndetësisë. Komuniteti rom dhe egjiptian vazhdon të përballet me vështirësi të mëdha në qasjen në shërbime shëndetësore cilësore, dhe kjo ka ndikuar në shëndetin e përgjithshëm të individëve të këtyre grupeve.

Një prej pengesave kryesore është mungesa e aksesit të barabartë në shërbimet shëndetësore. Shumë individë të komunitetit rom dhe egjiptian nuk kanë mundësi të përfitojnë nga shërbimet shëndetësore bazike, për shkak të mungesës së sigurimeve shëndetësore dhe mungesës së njohurive për mundësitë që ofrohen nga sistemet shëndetësore shtetërore. Edhe për ata që mund të kenë akses, ka një mungesë të theksuar të informacionit mbi shërbimet dhe trajtimet mjekësore të disponueshme, duke bërë të vështirë përdorimin efektiv të burimeve që janë në dispozicion.

Në fushën e shëndetit riprodhues, gratë e komunitetit rom dhe egjiptian shpesh janë të ekspozuara ndaj rreziqeve më të mëdha për shkak të mungesës së kujdesit prenatal dhe pas lindjes. Pavarësisht përpjekjeve për të ofruar shërbime shëndetësore për gratë dhe vajzat e këtij komuniteti, nivelet e

larta të lindjeve të hershme dhe komplikacioneve gjatë shtatzënisë janë ende të pranishme. Ka gjithashtu një mungesë të shërbimeve të shëndetit mendor dhe mbështetje për gratë pas lindjes, duke çuar në sfida të mëdha për shëndetin e përgjithshëm të grave të komunitetit.

Në lidhje me shëndetësinë, sipas të dhënave nga Regjistri Kombëtar Rom-Alb dhe NJVKSH Pogradec, rezulton se nga viti 2017 deri në vitin 2023, numri i individëve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian që kanë akses në shërbimet shëndetësore ka ardhur në rritje, me një kulm në vitin 2020, por me një rënie graduale në në vitin 2023. Kjo rënie mund të jetë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, përfshirë migrimin, mungesën e informacionit mbi shërbimet dhe kushtet socio-ekonomike.

Një tjetër problem shqetësues është situata e vaksinimit të fëmijëve, ku nga kërkimi drejtpërdrejt në terren, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë identifikuar si të pavaksinuar për arsye të ndryshme, si refuzimi nga prindërit, emigrimi apo ndryshimi i adresës. Në lidhje me këtë problem është e vështirë që të identifikohet numri i saktë i rasteve sepse nga institucionet na u raportua që nuk ka të pa vaksinuar, perjashto rastet që mund të ket ndonjë dozë pa plotësuar por jo baziket.

Gjithashtu, një sfidë tjetër e identifikuar është fenomeni i lindjeve të hershme, ku në vitin 2024 janë evidentuar dy raste lindjesh të hershme nga vajza minorene. Për sa i përket shëndetit të përgjithshëm, komuniteti Rom dhe Egjiptian në Pogradec përballet kryesisht me sëmundje kardiovaskulare si hipertensioni dhe insuficienca renale kronike, sëmundje pulmonare kronike si SPOK, si dhe sëmundje infektive si tuberkulozi dhe hepatiti. Nga institucioni raportohet se shërbimin shëndetësor në qendrat shëndetësore marrin të gjithë pavarësisht nëse kanë apo jo sigurime.

NJVKSH ka identifikuar 1 fëmijë të pavaksinuar i moshës 7 vjec për të cilin refuzojnë prindërit për tu vaksinuar. Ndërsa përsa i përket lindjeve të hershme nuk ka te dhëna të rregjistruara në Bashkinë Pogradec.

Në përpjekje për të informuar dhe ndërgjegjësuar komunitetin mbi rëndësinë e shëndetit dhe shërbimeve të disponueshme, janë organizuar aktivitete të shumta me fokus edukimin dhe sensibilizimin. Këto aktivitete përfshijnë informimin mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe mënyrat për ta parandaluar, rëndësinë e identifikimit të hershëm të problematikave të shëndetit mendor dhe

trajtimin e tyre nga mjekët specialistë, si dhe pasojat e përdorimit të substancave si kanabisi. Gjithashtu, janë organizuar aktivitete të dedikuara për Ditën e Diskriminimit Zero, ku komuniteti informohet mbi mënyrat për të kërkuar ndihmë në rast se përballet me diskriminim. Dita Ndërkombëtare e Grave shërben si një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe detyrimet e grave në shoqëri, ndërsa Dita Ndërkombëtare e Sindromës Don dhe Dita Botërore e Autizmit ndihmojnë në edukimin dhe sensibilizimin mbi këto çështje, duke promovuar përfshirjen dhe mbështetjen për fëmijët me nevoja të veçanta.

Ndër temat e tjera të trajtuara përfshihen edhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, lufta kundër punës së fëmijëve dhe parandalimi i dhunës seksuale gjatë konflikteve. Në këtë kontekst, është organizuar edhe Dita Ndërkombëtare e Romëve ku komuniteti mëson mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre si qytetarë të barabartë.

Një fokus i veçantë i këtyre iniciativave është mbrojtja e individëve nga trafikimi i personave dhe dhuna me bazë gjinore, duke përfshirë 16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Këto aktivitete synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe të nxisin raportimin e rasteve të dhunës dhe trafikimit. Gjithashtu, është organizuar Dita Botërore e Personave me Aftësi të Kufizuara, ku komuniteti informohet mbi shërbimet mbështetëse që ofrohen për këtë kategori, përfshirë kujdesin shëndetësor në banesë dhe përkujdesjen psikologjike në qendrat psikosociale.

- Përpjekjet për Përmirësim

-Në përgjigje të këtyre sfidave, janë ndërmarrë disa iniciativë dhe programe për të përmirësuar kushte shëndetësore për komunitetin rom dhe egjiptian. Pjesë e këtyre iniciativave është rritja e ndërgjegjësimit për shëndetin dhe ofrimi i mundësive për akses në trajtime dhe shërbime mjekësore për individët e këtij komuniteti. Po ashtu, janë ofruar mundësi për trajnimin e personelit mjekësor, për t'u bërë ata më të përgatitur për të trajtuar pacientët nga komunitetet më të margjinalizuara.

-Gjithashtu, ka pasur përpjekje për të përmirësuar qasjen në shërbimet e shëndetit mendor për individët që përballen me stres dhe problemet emocionale. Pavarësisht përpjekjeve për të ofruar shërbime shëndetësore, ende ka shumë punë për t'u bërë në këtë fushë, sidomos në lidhje me

ofrimin e shërbimeve të nevojshme dhe me ndihmën që mund të ofrohet për individët që kanë nevojë për mbështetje psikologjike.

- Rekomandime

-Për të përmirësuar situatën e shëndetit të komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkinë Pogradec, disa hapa janë të nevojshëm. Duhet të rritet ndërgjegjësimi dhe edukimi shëndetësor për komunitetin, duke i informuar ata për mundësitë që ofron sistemi shëndetësor dhe duke u mundësuar atyre të kenë njohuri më të mira mbi kujdesin shëndetësor. Për më tepër, është e nevojshme që shërbimet shëndetësore të bëhen më të aksesueshme për këtë komunitet, përfshirë mbështetje për ata që nuk kanë mundësi të paguajnë për shërbime mjekësore.

-Përgatitja e personelit shëndetësor për të ofruar trajtime të ndjeshme dhe të përshtatshme për komunitetin rom dhe egjiptian është gjithashtu shumë e rëndësishme, si dhe krijimi i mundësive për shërbime shëndetësore për individët që përballen me probleme shëndetësore mendore. Ndihma për shëndetin mendor është thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetës së këtij komuniteti dhe për të mundësuar një jetë më të shëndetshme dhe më të integruar shoqërisht.

-Përpjekjet për të adresuar këto sfida dhe për të krijuar mundësi për një jetë më të shëndetshme për komunitetin rom dhe egjiptian në Bashkinë Pogradec janë thelbësore për të siguruar një zhvillim më të mirë dhe një integrim të plotë në shoqëri.

Bashkia Pogradec, në bashkëpunim me struktura të ndryshme ofrojnë një sërë shërbimesh me fokus komunitetet e margjinalizuara ( përfshirë komunitetet rome dhe egjiptiane) sikurse gjenden të listuara më poshtë.

## SHËRBIMET E BASHKISË POGRADEC ME FOKUS KOMUNITETET E MARGJINALIZUARA

| Nr. | Viti i zbatimit *(kur ka filluar ofrimi i* | Tipologjia e Shërbimit të kujdesit shoqëror *(si* | Numri i Përfituesve | Numri stafit në | Financimi *(publik/jopublik)* | Komentet tuaja për shërbimin |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | *këtij shërbimi* | *dhe emri i shërbimit)* | | **ofrimin e shërbimit** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | 1991 | Fondacioni "Nehemia"<br><br>Sherbime komunitare | 320 | 6 | Jo Publik | Ofrojnë shërbime të specializuara dhe janë një mbështetje rëndësishme për komunitetin në nevojë. |
| **2** | 1998/ 1999 | Fondacioni "Diakonia Albania"<br><br>Sherbime komunitare | 10 | 10 | Jo Publik | Ofrojnë shërbime residenziale dhe ditore për të mitur dhe janë një mbështetje rëndësishme për komunitetin në nevojë. |
| **3** | 1994 | Qëndra "Drita e Shpresës" Sherbime komunitare | 183 | 11 | Jo Publik | Ofrojnë shërbime të specializuara dhe janë një mbështetje rëndësishme për komunitetin në nevojë. |
| **4** | 2008 | Amaro - Tan | 19 të rritur + 115 nxënës | 20 | Jo Publik | Ofron Mbështetje dhe ndihmë për komunitetin dhe arsim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | parauniversitar për fëmijët |
| 5 | 2017 | Qëndra Komunitare e Bashkisë | 52 | 15 | Publik | Shërbim Komunitar (fizioterapi, terapi zhvillimi në grup dhe individuale, klasa speciale mësimore), për personat me aftësi të kufizuar (PAK) |
| 6 | 2023 | Qëndra për Shërbime mbështetëse fizioterapic dhe sociale për kategorinë e personave në nevojë. | 80 | 3 | Publik | Në këtë Qëndër ofrohet shërbim për personat nga kategoritë në nevojë, para dhe tetraplegjikë, të moshuar, fëmije, personat e papunë dhe çdo individ që ka nevojë për trajtim të menjëhershëm me shërbime fizioterapeutike dhe asistencë psiko-sociale, individët që mund të kenë pësuar trauma ortopedike për shkak të ngricave tipike për klimën e qytetit të Pogradecit. Ky shërbim ofrohet në |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | kuadër të zbatimit të projektit të financuar nga Fondi Social 2023-2025 |
| **7** | 2024 | Qëndër ditore për të moshuar | 189 të moshuar të regjistruar, Rreth 40 frekuentime ditore | 1 | Publik | Kjo qëndër ka si target grup të moshuarit e vetmuar dhe në nevojë në qytetin e Pogradecit, duke përfshirë këtu edhe ata me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit e minoritetit rom dhe egjiptian. Të moshuarit kanë mundësi të socializojnë me njëri-tjetrin, ofrohet kafe/çaj pa pagesë |
| **8** | 2025 | Qëndër Multifunksionale për Promovimin e Përfshirjes dhe Zhvillimin e Aftësive | 100 | 3 | Publik | Kjo qëndër është në fillimet e funksionimit të saj dhe ofron shërbime qoftë për fëmijët me aftësi të kufizuara ose fëmijët e tjerë që vijnë nga grupe të ndryshme vulnerabël, përfshirë vulnerabilitetet që rrjedhin nga |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | pabarazitë gjinore. Qëndra do të plotësojë nevojat argëtuese, zhvillimore dhe sociale të të gjithë fëmijëve, me një fokus të veçantë tek ata me aftësi të kufizuara. Ajo do të ofrojë një gamë aktivitetesh, nga muzika dhe piktura, deri te zhvillimi i aftësive dhe integrimi social, si dhe krijimi i Këndit BiblioTech si një prani pozitive e njohur në komunitete, duke ofruar arsimim teknologjik dhe zhvillim aftësish digjitale për të gjithë fëmijët, në gjithë diversitetin e tyre. |

**VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT**

**Vizioni**

Bashkia Pogradec angazhohet për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj, pa marrë parasysh përkatësinë etnike. Ajo punon për të adresuar pabarazitë që ekzistojnë midis pakicave rome dhe egjiptiane dhe pjesës tjetër të popullsisë, duke zbatuar masa dhe aktivitete gjithëpërfshirëse dhe fuqizuese. Këto përpjekje synojnë integrimin e plotë të romëve dhe egjiptianëve në jetën sociale, ekonomike, kulturore dhe politike të Bashkisë Pogradec.

**Objektivat Strategjikë**

- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Pogradec do të kenë akses të plotë në shërbimet e gjendjes civile dhe ndihmës ligjore falas, me të gjithë ata të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.

- Fuqizimi ekonomik i individëve dhe familjeve nga pakicat rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes mundësive të punësimit të rregullt dhe të qëndrueshëm.

- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë një nivel më të lartë arsimor dhe akses më të mirë në arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës, përfshirë ata që janë kthyer nga emigracioni, në Bashkinë Pogradec.

- Ruajtja e diversitetit kulturor dhe promovimi i vlerave rome dhe egjiptiane do të jenë prioritete kyçe.

- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimet e strehimit dhe do të jetojnë në kushte më të mira strehimi dhe infrastrukture.

- Do të përmirësohet shëndeti dhe aksesin në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane.

- Rritja e mirëqenies sociale për këto grupe do të jetë një fokus i rëndësishëm.

- Do të eliminohet antixhipsizmi përmes njohjes dhe edukimit të shoqërisë, për të siguruar një mjedis të lirë nga diskriminimi ndaj këtyre grupeve.
- Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes statistikave, planifikimit dhe buxhetimit të ndjeshëm ndaj diversitetit rom dhe egjiptian

## MATRICA E PLANIT TË MASAVE

Plani i Masave

Matrica e Planit të Masave: Plani Vendor për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030, Bashkia Pogradec

| FUSHA E NDËRHYRJES: ARSIMI DHE DIVERSITETI KULTUROR | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik** | **1.** Përmirësimi i nivelit arsimor dhe ofrimi i aksesit më të gjerë në arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane, duke përfshirë ata që janë kthyer nga emigracioni, në Bashkinë Pogradec | | | | | |
| ***Objektivi specifik*** | 1.1. Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e arsimit në mesin e pakicave rome dhe egjiptiane. | | | | | |
| **Masat/veprimtaritë** | **Aktorët përgjegjës** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Financimi** | **Monitorimi** |
| 1.1.1 Formimi i grupeve të punës për realizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese midis bordeve të shkollave, Qendrës së Arsimit dhe drejtorive përkatëse në Bashki. | Zyra Vendore Arsimore, Bashkia Pogradec | Numri i grupeve dhe anëtarëve të ngritur, numri i aktiviteteve të realizuara, raportet e përgatitura nga grupet e punës. | Raportet e përgatitura nga grupi/et e punës | Çdo vit, para fillimit të vitit të ri shkollor<br>2026-2030 | Bazuar tek shpenzimet buxhetore të institucioneve përkatëse | Zyra Vendore Arsimore (ZVA) |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.2. Informimi dhe ndërgjegjësim i i komuniteteve rome dhe egjiptiane mbi rëndësinë e arsimimit (të hershëm dhe gjatë gjithë jetës), mundësitë për të (p.sh. mundësinë për bursa), si dhe kundër punësimit të fëmijëve dhe martesave të hershme që pengojnë arsimimin e tyre. | Bashkia Pogradec – Qendra e Arsimit dhe Specialist për pakicat<br><br>OSHC-të<br><br>Shkollat Qendra Komunitare (SHQK-të) | Numri i aktiviteteve informuese/ ndërgjegjësuese<br><br>Numri i aktiviteteve informuese/ ndërgjegjësuese për zonë me përqendrim të popullsisë rome/egjiptiane<br><br>Numri i pjesëmarrësve në aktivitete | Raportet e aktiviteteve | Çdo vit<br><br>2026-2030 | Bazuar tek shpenzimet buxhetore të institucioneve përkatëse | ZVA |
